

Osmani: Administrata
Trump konfirmoi
vazhdimin e programit
të MCC-së për Kosovën

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

EDHE KËTË VIT BLERJA E TEKSTEVE SHKOLLORE DO TË SUBVENCIONOHET NGA MASHTI

FAQE 4-5



Aplikimi për blerjen e teksteve
shkollore për nxënësit nga klasa
1 deri në të 9-n pritet të hapet në
fillim të muajit gusht, kanë bërë

me dije drejtues të Ministrisë së
Arsimit. Njohës të fushës së
arsimit po vlerësojnë se procesi i
furnizimit me tekste shkollore

për nxënësit në dy vitet e kaluara
është përcjellë me disa prob-
leme, por ka sjellë edhe disa për-
parësi

**BIZNESET
PA KONTRATA
RREZIKOJNË
SHKYÇJEN NGA
RRYMA MË
31 KORRIK** F. 8



**KOSOVA,
DIPLOMACI
TË HESHTUR
DHE PASIVE** F. 6

Shkruan: Prof.
dr. Fejzulla BERISHA



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**PARANDALOHET NJË RAST
I SHMANGIES NGA TAKSAT
DOGANORE** F. 8

SPORT



**XHAKA PAS PARAQITJES TE
SUNDERLANDI: DO TA SHKRUAJMË
HISTORINË** F. 10



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Osmani: Administrata Trump konfirmoi vazhdimin e programit të MCC-së për Kosovën

PRISHTINË, 30 KORRIK - Presidentja Vjosa Osmani tha se zëvendëssekretari amerikan i Shtetit, Christopher Landau, e ka informuar zyrtarisht se programi i Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC)

për Kosovën do të vazhdojë. “Pas takimeve të shkëlqyeshme në Uashington, ku diskutuam për rëndësinë e Kompaktit të MCC për Kosovën, jam informuar edhe zyrtarisht nga zv/sekretari

amerikan i Shtetit, Christopher Landau, se administrata Trump ka miratuar vazhdimin e këtij programi për Kosovën - një program me ndikim transformues për sektorin e

energjisë dhe zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Lajm i shkëlqyeshëm për Kosovën! Mirënjohje e thellë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës!”, ka shkruar Osmani në “Facebook”.



Tërmeti i fuqishëm pranë Rosisë shkakton paralajmërime për cunami, evakuime në ShBA dhe Japoni

Një tërmet me magnitudë 8.8, një ndër më të fuqishmit ndonjëherë, goditi të mërkurën gadishullin Kamçatka në lindjen e largët të Rosisë, duke shkaktuar një cunami deri në katër metra të lartë, dëmtime në ndërtesa dhe duke nxitur paralajmërime dhe evakuime në të gjithë Oqeanin Paqësor, raportoi “Reuters”. Gjatë orëve të fundit disa shtete, përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe Japoninë, kanë lëshuar paralajmërime për cunami dhe urdhra për evakuime. Në Kamçatka disa persona janë lënduar, ndërsa në një pjesë të madhe të bregdetit lindor të Japonisë, i cili ishte goditur rëndë në tërmetin dhe cunamin katastrofik të vitit 2011, është urdhëruar evakuimi i popullatës. “Tërmeti i sotëm ishte shumë serioz dhe më i fuqishmi në dhjetë vitet e fundit”, tha guvernatori i Kamçatkës në një postim në “Telegram”.

Sipas ministrit rajonal për emergjenca, Sergei Lebedev, pas tërmetit është regjistruar një cunami me lartësi nga 3 deri në 4 metra. “Të gjithë duhet të largohen menjëherë nga bregdeti”, theksoi ai në një video të shpërndarë në

rretet sociale. Sipas Degës Lokale të Institutit Gjeofizik të Akademisë së Shkencave të Rosisë, ky ishte tërmeti më i fuqishëm që nga viti 1952 në atë zonë. Ata e cilësuan tërmetin si një “ngjarje unike” në deklaratën e publikuar në Telegram.

Epiqendra ndodhej pranë zonës që u godit nga një tjetër tërmet më 20 korrik. Shkencëtarët deklaruan se situata është “nën kontroll”, por paralajmëruan për pasgoditje që mund të zgjasin deri në një muaj dhe këshilluan qytetarët t’i shmangin zonat bregdetare për arsye sigurie. Sipas Institutit Amerikan të Sizmologjisë, tërmeti ndodhi në një thellësi prej 19.3 kilometrash, rreth 125 kilometra nga Petropavlovsk, qytet me rreth 165 000 banorë në bregdetin e gjirit Avaça.

Japonia evakuon 1.9 milion banorë

Agjencia Meteorologjike e Japonisë paralajmëroi për valë cunami deri në 3 metra përgjatë



pjesës më të madhe të bregdetit. Televizioni publik NHK raportoi se mbi 1.9 milion persona janë urdhëruar të evakuhohen në vende të sigurta pasi valët filluan ta godasin bregun. Megjithëse valët ishin më të vogla sesa parashikimet fillestare, ka pasur ndërprerje të trafikut në mbarë vendin. Agjencia Japoneze për Menaxhimin e Zjarreve dhe Katastrofave konfirmoi se rreth dy milionë banorë në 21 prefektura ishin nën urdhër evakuimi. Punonjësit në centralin bërthamor të dëmtuar të Fukushima-së u

evakuuan të mërkurën, raportoi AFP. Sistemi amerikan i paralajmërimit për cunami është aktivizuar për të paralajmëruar për valë që mund ta godasin bregun perëndimor të ShBA-së. Parashikimet tregojnë se valë deri në 3 metra mund ta godasin bregdetin e Rosisë dhe Ekuadorit, ndërsa valë nga 1 deri në 3 metra mund t’i prekin Japoninë, Havain, Kilin dhe Ishujt Solomon. Në Havai u urdhërua evakuimi i disa zonave bregdetare. “Largohuni menjëherë, priten cuname shkatërruese”, u tha në

një deklaratë të Zyrës për Emergjenca në Honolulu. Guvernatori i Havait, Josh Green, kërkoi qetësi dhe sjellje të përgjegjshme nga qytetarët. “Ju lutem, qëndroni të qetë. Nëse jeni në zona të ulëta, shkoni menjëherë në vende më të larta”, tha ai. Ai shtoi se rrugët janë të mbushura dhe u kërkoi qytetarëve të bashkëpunojnë dhe ta shmangin panikun, raportoi BBC. Por, disa orë më vonë, paralajmërimi për cunami që mbulonte Havain është ulur në një paralajmërim të nivelit të ulët, njoftoi Qendra e Paralajmërimeve për Cunami në Paqësor. Sipas përditësimit të fundit, kjo nënkupton se ekziston rreziku për valë të fuqishme, përmbetje të vogla dhe rryma të forta, por nuk pritet që ndonjë cunami i madh ta godasë zonën. Drejtori i Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave në Havai, Stephen Logan, tha se personat e evakuuar mund të kthehen në shtëpi. Qytetarëve iu bë thirrje të lëvizin me kujdes, të ngasin ngadalë dhe të jenë të vëmendshëm ndaj përmbetjeve të mundshme në disa zona.

Gjermania rrit fondet për ushtrinë dhe infrastrukturën



Berlin, 30 korrik - Kabineti qeveritar gjerman miratoi të mërkurën një projektbuxhet për vitin 2026, thanë burime qeveritare, duke hapur rrugën për të shpenzuar qindra miliarda euro për infrastrukturë dhe mbrojtje, raporton DPA. Buxheti i Ministrit të Financave, Lars Klingbeil, për vitin e ardhshëm parashikon

shpenzime prej rreth 520 miliardë eurosh dhe një borxh të ri në vlerë rreth 174 miliardë euro. Qeveria e re gjermane, që mori detyrën në maj, ka premtuar t’i rrisë ndjeshëm investimet për ta përditësuar infrastrukturën e amortizuar të vendit dhe për ta riarmatosur ushtrinë gjermane. Buxheti për vitin 2025, i cili u

miratua nga kabineti në qershor, mbetet ende në shqyrtim dhe pritet të miratohet në parlament pas pushimeve verore. Buxheti për vitin pasues pritet të hidhet në votim në Bundestag, dhoma e ulët e parlamentit, në nëntor. Projektbuxheti thekson si përparësi investimet për rritje

ekonomike, më shumë punësim dhe modernizimin e Gjermanisë. Ministri i Financave ka paralajmëruar këtë javë se nga viti 2027 priten masa të konsiderueshme kursimi, pasi në buxhetin federal parashikohet një mungesë fondesh prej rreth 172 miliardë eurosh.

Filipinet, Meksika dhe Zelanda e Re, thirrje për kujdes

Autoritetet filipineze këshilluan njerëzit të qëndrojnë larg plazheve dhe zonave bregdetare. “Nuk mund të jenë valët më të mëdha, por ato mund të vazhdojnë për orë të tëra dhe të rrezikojnë njerëzit që notojnë në ujë”, tha për AP-në Teresito Bacolcol nga Instituti i Vullkanologjisë dhe Sizmologjisë. Marina e Meksikës

paralajmëroi se valët e cunamit do të fillojnë të arrijnë bregun verior në Ensenada, pranë Kalifornisë, rreth orës 02:22 të mëngjesit të së mërkurës sipas orës lokale, dhe valët mund të përparojnë përgjatë bregut të Paqësorit deri në Chiapas, rreth orës 07:15 të mëngjesit. Autoritetet në Zelandën e Re paralajmëruan për “rrjedha të forta dhe të pazakonta dhe valë

të paparashikueshme” përgjatë të gjithë bregdetit të këtij shteti ishullor në Paqësorin Jugor. Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave tha se njerëzit duhet të largohen nga uji, plazhet dhe zonat pranë porteve, marinave, lumenjve dhe deltave. Tërmeti ishte më i forti që ka goditur këtë zonë në Gadishullin Kamçatka që nga

viti 1952, sipas degës lokale të Sondazhit Gjeofizik të Akademisë Ruse të Shkencave. Tërmeti me magnitudë 9.0, më 4 nëntor 1952, në Kamçatka shkaktoi dëme, por nuk pati viktima të raportuara, megjithëse shkaktoi valë prej 9.1 metrash në Havai. Ata thanë se edhe pse situata “ishte nën kontroll”, ekzistonte rreziku i pasgoditjeve që mund të

zgjasin deri në një muaj dhe paralajmëruan që të mos vizitohen disa zona bregdetare. Më herët, në korrik, pesë tërmete të fuqishme - më i madhi me magnitudë 7.4 - goditën në det pranë Kamçatka. Tërmeti më i madh ishte në një thellësi prej 20 kilometrash dhe ndodhej 144 kilometra në lindje të qytetit Petropavlovsk.

BRITANIA, FRANCA DHE ITALIA VLERËSOJNË ROLIN E KFOR-it DHE FSK-së NË OPERACIONIN E KËRKIMIT NË UJMAN

PRISHTINË, 30 KORRIK - Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë ka vlerësuar koordinimin mes misionit të KFOR-it dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës në operacionin e kërkim-shpëtimit të Rr. L., që ishte zhdukur në liqenin e Ujmanit në Zubin Potok.

Në një deklaratë, Ambasada Britanike thekson se ky operacion është dëshmi e aftësive të shkëlqyera të FSK-së në kërkim dhe shpëtim dhe se bashkëpunimi me KFOR-in është në përputhje me marrëveshjet ndërmjet dy institucioneve.

Ambasada Britanike ka përgëzuar KFOR-in për sigurimin dhe mbështetjen gjatë tërë operacionit dhe ka shprehur ngushëllime për familjen e viktimës. “Mbretëria

e Bashkuar mbështet plotësisht misionin e KFOR-it për të kontribuar në një ambient të sigurt për të gjithë qytetarët dhe komunitetet në Kosovë. Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet KFOR-it, FSK-së, Policisë së Kosovës dhe EULEX-it është thelbësor për suksesin e këtij misioni”, thuhet në reagim. Edhe Ambasadori i Francës në Kosovë ka shprehur mbështetjen e plotë të shtetit francez për KFOR-in dhe komandantin e tij. “Që nga krijimi i tij, KFOR-i ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol të pazëvendësueshëm në garantimin e sigurisë për të gjithë. Ai meriton respektin dhe mirënjohjen e të gjithë aktorëve në rajon. Franca do të vazhdojë ta mbështesë plotësisht, sidomos në një kontekst ku

dezinformimi dhe manipulimi i informacionit po bëhen sistematike”, shkroi ambasadori Olivier Guerot në platformën “X”. Ai, gjithashtu, ka vlerësuar mediet që kanë raportuar saktë për rolin e KFOR-it në përpjekjet për gjetjen e trupit të personit të zhdukur në liqenin e Ujmanit.

Në lidhje me operacionin ka reaguar edhe Ambasada e Italisë në Kosovë. Reagimi u shpreh mbështetje misionit të KFOR-it dhe komandantit të KFOR-it që, siç thuhet, “ka vepruar brenda kufijve të mandatit të tij përballë një rrethane fatkeqe që kërkonte ndërhyrjen e ekipit për arsye humanitare”.

Një ditë më parë Ambasada e Gjermanisë në Kosovë tha se është thellësisht e shqetësuar

nga përpjekjet për ta politizuar angazhimin e ekipeve të kërkim-shpëtimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Liqenin e Ujmanit. “Humbja tragjike e jetës së një të riu duhet të jetë moment i pikëllimit kolektiv dhe jo rast për të fituar pikë politike”, u tha në reagimin e Ambasadës gjermane.

Operacioni i kërkim-shpëtimit nisi më 27 korrik, por Agjencia për Menaxhim Emergjent kërkoi asistimin e FSK-së për nxjerrjen e trupit të Rr. L., i cili dyshohet se kërceu nga lartësia e një ure në Ujman.

Dislokimi i FSK-së u bë i mundur vetëm pas dhënies së pëlqimit nga komandanti i KFOR-it.

FSK-ja brenda pak orësh arriti ta identifikojë dhe nxjerrë nga thellësia trupin e 33-vjeçrit.

Dislokimi i FSK-së në veri të vendit është i mundur vetëm me pëlqimin paraprak të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, bazuar në zotimin e vitit 2013 nga Qeveria e Kosovës ndaj NATO-s. Ky zotim, i dhënë përmes një letre nga ish-kryeministri Hashim Thaçi drejtuar sekretarit të atëhershëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, mbetet në fuqi edhe sot, pavarësisht prej ndryshimeve në mandatin e FSK-së.

Pas këtij rasti Policia e Kosovës u ka bërë thirrje qytetarëve të mos kërcejnë nga ura në Ujman.

Ndryshe, FSK-ja është në proces të transformimit të saj në ushtri, pas ndryshimeve ligjore të miratuara. Ky proces pritet të përmbyllet më 2028.



KUNDËRVAJTJET NË TRAFIK, SHPESH TË PANDËSHKUARA DHE ME ZBUTJE TË GJOBAVE

PRISHTINË, 30 KORRIK - Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka identifikuar disa të meta në mënyrën se si zyrtarët policorë i shqiptojnë gjobat për kundërvajtjet në trafik, duke shtuar se këto shkelje “sjellin dyshime se mund të abuzohet gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”.

IPK-ja tha se e kishte nisur këtë inspektim pasi kishte marrë informacion se zyrtarët policorë nuk i gjobisin kundërvajtësit për shkeljet që i kanë kryer.

Dhe rezultati i inspektimit? Nga 590 raste të analizuar, në të cilët ka pasur shkelje të shpejtësisë së lejuar për të paktën 20 kilometra në orë, vetëm 35 për qind e ngasësve janë gjobitur.

Për më tepër, në 40 për qind prej gjobave të shqiptuara janë



vërejtur mospërputhje. Herë shpejtësia e lëvizjes është shkruar në gjobë të jetë më e ulët sesa e regjistruar në radar, herë të tjera shpejtësia e

kufizuar në gjobë është shkruar të jetë ndryshe nga ajo e regjistruar në radar. Sipas raportit të IPK-së, kjo gjë dyshohet se është bërë me

synim për ta zbutur dënimin dhe për t’iu shmangur gjobave më të rënda.

Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugor parasheh gjobë deri në

500 euro për ata që vozisin mbi 100 kilometra në orë mbi shpejtësinë e lejuar, deri në 300 euro për ata që vozisin nga 50 në 100 kilometra në orë mbi shpejtësinë e lejuar.

Gjobat shkojnë duke u ulur varësisht nga tejkalimi i shpejtësisë, deri në 20 euro për tejkalimin nga 10 deri në 20 kilometra në orë.

Përveç gjobave financiare, shoferët ndëshkohen edhe me pikë negative - me nëntë pikë negative, një shoferit i pezullohet patentshoferi - dhe marrje e përkohshme e lejes për vozitje.

Që të përmirësohet mënyra e përdorimit të radarëve për matjen e shpejtësisë së lëvizjes, IPK-ja ka rekomanduar trajnime shtesë për personelin dhe kryerjen më të rregullt të kontrolleve dhe monitorimit.

EDHE KËTË VIT BLERJA E TEKSTEVE SHKOLLORE DO TË SUBVENCIONOHET NGA MASHTI

Aplikimi për blerjen e teksteve shkollore për nxënësit nga klasa e 1 deri në të 9-n pritet të hapet në fillim të muajit gusht, kanë bërë me dije drejtues të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Njohës të fushës së arsimit po vlerësojnë se procesi i furnizimit me tekste shkollore për nxënësit dy vitet e kaluara është përcjellë me disa probleme, por ka sjellë edhe disa përparësi

PRISHTINË, 30 KORRIK - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) edhe këtë vit do t'i subvencionojë prindërit për blerjen e teksteve shkollore për nxënësit nga klasa 1 deri në të 9-n. Aplikimi pritet të hapet në fillim të muajit gusht. Kështu kanë bërë me dije drejtues të Ministrisë së Arsimit. Ndërsa njohës të fushës së arsimit po vlerësojnë se procesi i furnizimit me tekste shkollore për nxënësit dy vitet e kaluara është përcjellë me disa probleme, por ka sjellë edhe disa përparësi. Edhe përkundër që dy vitet e kaluara ka pasur pakënaqësi nga prindërit dhe është vlerësuar si jo i qëlluar subvencionimi i prindërve për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore, edhe këtë vit Ministria e Arsimit pritet që së shpejti ta hapë thirrjen për aplikim. Ministria e Arsimit në një përgjigje me shkrim për "Radio Kosovën" ka bërë me dije se të

gjithë nxënësit do të kenë kohë të mjaftueshme të pajisen me tekste shkollore para fillimit të vitit të ri shkollor. "Procesi dhe shpallja e thirrjes për subvencionim nga MASHTI do të publikohet së shpejti, dhe të gjithë përfituesit e kësaj skeme do të kenë kohë të mjaftueshme për t'u furnizuar me tekste shkollore dhe materiale mësimore para fillimit të vitit shkollor 2025/2026". Në përgjigjen e Ministrisë theksohet se këtë vit ministria, përmes grupeve punuese, ka analizuar dhe ka nxjerrë rekomandime e reflektime mbi bazën e përvojës nga vitet e kaluara. "Grupet punuese në kuadër të MASHTI-t kanë analizuar dhe kanë nxjerrë rekomandime e reflektime mbi bazën e përvojës nga vitet e kaluara. Procesi dhe shpallja gjithashtu, përgatitja e moduleve të veçanta për verifikimin e nxënësve është duke u avancuar nga Agjencia e Shqipërisë së



Informacionit, ndërsa roli i shkollave do të jetë më aktiv për të siguruar që mjetet të shkojnë te secili nxënës dhe furnizimi me tekste shkollore të realizohet me transparencë të plotë." Procesi i subvencionimit me tekste shkollore për nxënësit, njohës të fushës së arsimit po e vlerësojnë se ka sjellë disa probleme për sa i përket shpërndarjes së tyre. Xhavit Rexhaj i tha "Radio Kosovës" se ky proces është përcjellë me disa probleme, por se ka edhe përparësitë e veta. "Një proces me disa përparësi

por edhe dobësitë e veta e të cilat janë shfaqur në dy vitet e zbatimit të deritanishëm. Është pikërisht angazhimi i prindërve ajo pjesa të cilën unë e konsideroj që është prej dobësive, sepse njësoj mendoj se ka qenë shtimi i hallkës së librarive edhe një hallkë shtesë që prindërit duhet të shkojnë në librari t'i marrin tekstet e jo siç ka qenë më herët tekstet shkonin në shkollë. Mirëpo, kjo i ka edhe anët pozitive që është se tash mësimdhënësit vërtet i zgjedhin tekstet të cilat janë më të përshtatshme për ta e jo si më

herët që këtë e bënte ministria dhe nuk lejohej ajo qasja e duhur e alternativave, e zgjedhjes së mësimdhënësvë e të tjera. Po ashtu qasja e re ka ndikuar që të ketë vonesa në furnizim me libra". Ndërkohë, Zyra Kombëtare e Auditorit për vitin 2024 ka publikuar disa parregullsi që janë gjetur në ndarjen e subvencioneve për nxënësit nga klasa 1-9. Sipas ZKA-së, 154 përfitues në shumën prej 14 mijë e 150 euro ishin jashtë vendit, por të njëjtët morën subvencione nga shteti për blerje të librave.

NGA TETORI NIS ZBATIMI I RREGULLAVE TË REJA PËR UDHËTIME NË ZONËN SCHENGEN

PRISHTINË, 30 KORRIK - Bashkimi Evropian njoftoi se sistemi i ri i kontrollit kufitar për shtetasit që nuk janë nga blloku evropian, i cili do t'i japë fund vendosjes së vulave nëpër pasaporta, do të nisë në tetor. I ashtuquajtur i Sistem i Hyrje/Daljes (EES) fillimisht ishte paraparë të hynte në fuqi nëntorin e vitit të kaluar, por u shty në çastet e fundit pasi disa shtete ende nuk ishin të gatshme ta zbatonin. Komisioni Evropian ka vendosur 12 tetorin e vitit 2025 datë për nisjen e operacioneve për zbatimin e EES-së. Nga 12 tetori e tutje, EES-ja do të nisë gradualisht të zbatohet në kufijtë e jashtëm të 29 shteteve evropiane për gjashtë muaj. Ky zbatim gradual do t'u japë autoriteteve, pasagjerëve dhe industrisë së transportit më shumë kohë për t'u përshtatur me procedurat e reja, tha BE-ja. Sistemi është krijuar në nëntor të vitit 2017 dhe zbatimi i tij u shty disa herë. Sistemi pritet të vlejë për rreth 60 vende, përfshirë edhe ato të Ballkanit Perëndimor, për hyrjen e tyre në BE, si dhe në



Zvicër, Norvegji, Islandë dhe Lihtenshtajn, të cilat janë pjesë e zonës Schengen, raporton REL. EES-ja do ta regjistrojë datën e hyrjes dhe daljes së vizitorëve dhe do të ketë të dhëna për qëndrimet e tejkzgatura dhe hyrjet e refuzuara. Sipas sistemit të ri, udhëtarëve do t'u mblidhen të dhënat personale dhe biometrike - fotografite e fytyrës dhe gjurmët

e gishtërinjve. Pasaportat në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor janë biometrike; në çipet e tyre ruhen gjurmët e gishtërinjve dhe fotografia, dhe janë plotësisht të harmonizuara me kushtet që ka kërkuar Bashkimi Evropian, në mënyrë që vendet e Ballkanit Perëndimor ta përfitojnë regjimin pa viza.

Zbatimi i këtij sistemi ka rritur frikën se do të ketë radhë dhe pritje të gjata për njerëzit që udhëtojnë për në Evropë me trena, tragete dhe aeroplanë. Në mars disa shtete anëtare u pajtuan që zbatimi të bëhet përmes fazave, që do të nisë më 12 tetor. "Kjo do të rrisë sigurinë... duke na ndihmuar që të identifikojmë personat që

tejkalojnë kohën e qëndrimit, të parandalojmë lëvizjet e parregullta dhe të ulim mashtrimet me dokumente dhe identitete", tha Magnus Brunner, komisionar për Migrim. Komisioni Evropian tha se për udhëtarët do të ketë fushata informuese në aeroporte dhe në pikëkalime kufitare në mbarë BE-në para se të nisë zbatimi i sistemit. Sipas tij, periudha gjashtëmujore, sa është vendosur koha për përshtatjen me këtë sistem, është kohë e mjaftueshme për shtetet anëtare, udhëtarët dhe bizneset që të përshtaten me sistemin e ri. Sipas zbatimit të planifikuar në faza, vendet anëtare të BE-së duhet të fillojnë të operojnë sistemin në gjysmën e pikave kufitare pas tre muajsh dhe ta kenë tërësisht funksional atë pas gjashtë muajsh. "EES mund t'i marrë secilit udhëtar disa minuta shtesë për t'u përfunduar, prandaj përgatituni të prisni më gjatë se zakonisht në kufi sapo të nisë sistemin", tha Ministria e Jashtme e Britanisë në një përditësim për udhëtime.

KAMBERI: SITUATA E SHQIPTARËVE TË LUGINËS DUHET TË JETË PJESË E DIALOGUT NË BRUKSEL

PRISHTINË, 30 KORRIK - Deputeti shqiptar nga Bujanoci në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, e ka dorëzuar një draft-rezolutë në këtë institucion lidhur me situatën e shqiptarëve në jug të Serbisë dhe ka propozuar që kjo temë të jetë pjesë e dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Në Serbi jetojnë më shumë se 60 000 shqiptarë të cilët përbëjnë pakicën e katërt më të madhe atje, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë më 2022. Ata jetojnë në Luginën e Preshevës - term që përdoret për Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin. Në draft-rezolutën e Kamberit kërkohet që Kuvendi i Serbisë "ta pranojë qasjen diskriminuese dhe të shprehë përkushtim institucional për ta përmirësuar pozicionin e komunitetit shqiptar në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës". Dokumenti bën thirrje për zbatim të marrëveshjeve të viteve 2001, 2009 dhe 2013 dhe për pezullim të menjëhershëm të masave administrative për pasivizim të adresave. Pasivizimi nënkupton fshirjen e qytetarëve prej adresave ku kanë qenë të regjistruar. Ky hap rezulton me humbjen e shtetësisë serbe, rrjedhimisht të të gjitha të drejtave civile, përfshirë të drejtën për të votuar, për të pasur pronë, për të pasur sigurim shëndetësor dhe pension dhe për t'u punësuar. Kjo çështje është përmendur edhe në raportin e Departamentit

Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut në Serbi për vitin 2023. Në të është thënë se pasivizimi i adresave duket se është kryer në mënyrë joproporcionale ndaj shqiptarëve, sidomos në Medvegjë. Përveç kësaj, në mesin e problemeve të tjera të shqiptarëve janë përmendur edhe: mosnjohja e diplomave të lëshuara nga autoritetet e Kosovës, mungesa e një përfaqësimi të drejtë dhe proporcional në institucione shtetërore, pengesat në përdorim zyrtar të gjuhës shqipe dhe simboleve kombëtare, si dhe mungesa e zhvillimit ekonomik në atë rajon. Në draft-rezolutë është thënë se për shkak të mungesës së rezultateve nga përpjekjet e kaluara institucionale, propozohet që statusi i shqiptarëve në jug të Serbisë të përfshihet në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, "në kuadër të përpjekjeve gjithëpërfshirëse për të arritur paqe të qëndrueshme". "Miratimi i rezolutës do të ishte dëshmi e gatishmërisë politike për t'i zgjidhur problemet e zvarritura me dekada dhe për të garantuar qasje të barabartë për të gjithë qytetarët, pavarësisht etnisë - çka është kusht bazik për zhvillim demokratik dhe përparim drejt Bashkimit Evropian", ka thënë Kamberi. Draft-rezoluta është nënshkruar nga dy deputetë të tjerë nga Partia për Veprim Demokratik e Sanxhakut.



Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, e ka hedhur poshtë propozimin e Kamberit, duke thënë se pozita e shqiptarëve në jug të Serbisë nuk është dhe nuk do të jetë pjesë e negociatave mes Serbisë dhe Kosovës. "Nuk do të kenë sukses tentimet për ta keqpërdorur dialogun me Prishtinën dhe për ta instrumentalizuar politikisht nga politikanë të papërgjegjshëm në pjesën qendrore të Serbisë", ka thënë Petković.

Ai pretendon se "Serbia njihet si shtet që ka bashkëpunim të jashtëzakonshëm me minoritetet dhe që është model për të gjithë në rajon". Kosova dhe Serbia dialogojnë në Bruksel me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian që prej vitit 2011. Palët i kanë arritur disa marrëveshje, por jo të gjitha janë zbatuar. Aktualisht dialogu është ngrirë edhe për faktin që Kosova ka qeveri në detyrë me kompetenca të kufizuara. Përfaqësuesit e shqiptarëve nga

jugu i Serbisë janë deklaruar shpesh për problemet dhe kanë thënë se diskriminohen, diçka që Beogradi e mohon. Autoritetet e Kosovës kanë përsëritur disa herë se janë të përkushtuara për ta ngritur zërin për shqetësimet e banorëve të Luginës së Preshevës dhe kanë ndarë miliona euro si ndihmë për ta. Megjithatë, mungesa e investimeve dhe barrierat e vazhdueshme besohet se kanë ndikuar në largimin e rreth 20 000 shqiptarëve prej këtij rajoni, kryesisht drejt shtetit të Kosovës.

GJENERALI BERISHA THOTË SE KJO QEVERI PO KEQPËRDOR ÇDO MEKANIZËM, PO TENTON EDHE FSK-NË

PRISHTINË, 30 KORRIK - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, gjenerali në pension, Hisen Berisha, ka komentuar ngjarjen në Liqenin e Ujmanit, ku një 33-vjeçar u gjet pa shenja jetë, por që ky rast u keqpërdor politikisht nga LV-ja, e cila tha se "FSK-ja për herë të parë si ushtri në veri të vendit". Berisha në një intervistë për "Breaking" në "Top Channel" ka thënë se kjo është një tendencë e radhës e partisë në pushtet për të përfutur në çdo fatkeqësi, e duke keqpërdorur çdo mekanizëm, në këtë rast edhe FSK-në. "Tendenca për të përfutur në çdo fatkeqësi, qoftë edhe kur luhet me jetë njerëzish për të ngritur ca poenë politike atje, për një retorikë atje të karakterit më shumë të nxitjes së militantizmit të brendshëm partiak. Po keqpërdoret çdo mekanizëm, dhe segmenti i fundit që ka ngelur ende pa u deligitimuar tërësisht, krahas Prokurorisë Speciale, d.m.th ka mbetur edhe Forca e Sigurisë së Kosovës, e cila, edhe pse është degraduar në masë në aspektin e



kushteve dhe të zhvillimit të brendshëm, tani po tentohet që ajo të dëmtohet edhe në aspektin e bashkëpunimit të pashmangshëm dhe të domosdoshëm që ka me praninë

ushtarake ndërkombëtare brenda vendit. Kjo qeveri që është sot ka hyrë në politikë me dy viktima, nëse i mbani në mend ato përrallat e saj jo UNMIK-ut, jo EULEX... Arben

Gjeladini dhe Mon Balaj kanë qenë dy viktimat e protestave të motivuara gabimisht, sepse gjithçka që ishte zhvilluar më tutje ishte pavarësi dhe shtet. Pastaj për të hyrë në qeverisje

erdhi edhe me dy viktima të radhës që janë vëllezërit Dehari", ka thënë Berisha. Berisha ka folur edhe për hapjen e urave të reja. "Çdo tendencë për të ndërtuar ura, për t'i depërtuar trupat, ku ta di unë, është retorikë sa për efekte elektorale dhe mobilizim të militantizmit, sepse nuk mund të bëhet ndryshe pa u koordinuar me KFOR-in", ka theksuar gjenerali Berisha. Ai ka thënë se FSK-ja e ka mandatin me ligj të miratuar në dhjetor të vitit 2018 ku i jepet misioni përmes katër fushave: Mbrojtja e integritetit territorial, që nënkupton nxjerrjen e forcave në vijat e frontit kur ka invazion territorial; Mbështetja ushtarake e autoriteteve civile, që nënkupton reagimin në emergjencë që shkaktohen nga natyra apo njeriu, pra siç është edhe ky rast i kërkim-shpëtimit; Fusha e operacioneve ndërkombëtare që përfshin operacionet e mbështetjes së paqes; dhe përgjigjet në rastet e fatkeqësive.

KOSOVA ME DIPLOMACI TË HESHTUR DHE PASIVE



Shkruan: Prof. dr. Fejzulla BERISHA
(Ekspt i së drejtës publike)

I. Heshtja diplomatike si simptomë e dështimit të strategjisë shtetërore

Në politikën ndërkombëtare, heshtja nuk është gjithmonë sinonim i urtësisë. Për një shtet të ri dhe me pozitë të brishtë ndërkombëtare si Kosova, heshtja dhe pasiviteti diplomatik përkthehen në zbehje të subjektivitetit ndërkombëtar, në stagnim të projektit shtetëror dhe në ngecje të integritetit global. Sot, Kosova përballat me një krizë të thellë në politikën e jashtme: diplomatët janë jofunksionalë, përfaqësimi ndërkombëtar është sporadik dhe jokonsistent, ndërsa qëndrimet zyrtare vonohen dhe shpesh mungojnë profesionalizmin e domosdoshëm.

II. Diplomacia e heshtur dhe ajo pasive: Noci, dallime dhe rrezikshmëri për shtetin e ri

1. Diplomacia e heshtur

Diplomacia e heshtur shpesh praktikohet nga shtete të konsoliduara dhe me ndikim global, për të zhvilluar politika afatgjata, negociata të mbyllura dhe për të shmangur përplasjet publike. Kjo diplomaci bazohet në fuqi reale, kapacitete strategjike dhe struktura të forta institucionale.

Shembull ndërkombëtar: Politika fillestare e Gjermanisë ndaj Rusisë pas vitit 2014 ishte formalisht e heshtur, por u mbështet në një strategji të qartë

energjetike dhe të sigurisë, e cila më vonë u përkthye në masa konkrete në kuadër të BE-së.

2. Diplomacia pasive

Ndryshe nga ajo e heshtur, diplomacia pasive nënkupton mungesë reagimi, mungesë iniciative dhe paaftësi institucionale për të identifikuar dhe shfrytëzuar mundësitë ndërkombëtare. Në rastin e Kosovës, diplomacia pasive është shndërruar në një strukturë të institucionalizuar të mosveprimit. Shembull konkret nga Kosova: Nga viti 2021 deri në 2025, Kosova nuk aplikoi në asnjë organizatë ndërkombëtare për anëtarësim të plotë, përjashtojë përpjekjen e pasuksesshme për anëtarësim në Këshillin e Evropës, e cila u tërhoq në fazën vendimtare nga vetë Qeveria e Kosovës.

III. Ilustrime të pasivitetit diplomatik të Kosovës në raste konkrete ndërkombëtare

1. Rasti i Këshillit të Evropës (2023 - 2024)

Kosova e kaloi me sukses fazën në Asamblenë Parlamentare të KiE, por përpara votimit në Këshillin e Ministrave, aplikimi u tërhoq me arsyetimin se “koha nuk ishte e përshtatshme”. Analizë: Ky ishte akt i vetësabotimit diplomatik. Në vend që të intensifikohej lobimi ndaj vendeve kyçe si Franca, u zgjodh heshtja, duke dhënë një sinjal të gabuar se Kosova nuk ishte e gatshme për anëtarësim. Pasojë: Procesi i shqyrtimit të aplikimit u shty për një kohë të pacaktuar, ndërsa Serbia e interpretoi këtë si dështim të Kosovës për të përmbushur standardet e të drejtave të njeriut, pa asnjë kundërpërgjigje serioze nga diplomacia kosovare.

2. Marrëveshja e Brukselit dhe Aneksi i Ohrit (2023)

Kosova nënshkroi Marrëveshjen Bazë me Serbinë dhe aneksin



për zbatim, që përfshinte krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Më vonë, Qeveria refuzoi zbatimin, pa e shoqëruar këtë me një strategji bindëse diplomatike.

Pasojë ndërkombëtare: Kosova u perceptua si palë jo e besueshme. Partnerët ndërkombëtarë ndërprejnë mbështetjen për anëtarësim në organizata dhe u rrit distanca nga vendet që s’e njohin ende Kosovën si Spanja, Greqia dhe Rumania.

3. Çnjohjet diplomatike dhe mungesa e kundërofensivës

Në periudhën 2017- 2023, Kosova humbi më shumë se 15 njohje diplomatike, pa ndonjë përgjigje aktive nga institucionet. Përballë ofensivës së Serbisë, të mbështetur nga Rusia dhe Kina, Kosova nuk ndërmori asnjë kundërveprim strategjik. Mungesa e reagimit diplomatik: Nuk u thirr asnjë konferencë ndërkombëtare për çështjen; Nuk u hartua asnjë plan për rikthimin e njohjeve; Ambasadat ishin të papërgatitura dhe pa udhëzime konkrete.

Krahasim: Serbia organizon forume me vendet afrikane e arabe, ofron bursa dhe ndihma teknike, ndërsa Kosova nuk ka mekanizma funksionalë për diplomaci bilaterale as buxhet të mjaftueshëm për të ndërtuar partneritete.

IV. Shkaqet sistematike të diplomacisë pasive në Kosovë

Politizimi ekstrem i shërbimit diplomatik: Emërimi i ambasadorëve pa kriter meritokracie dhe pa përvojë. Mungesa e trajnimeve dhe mungesa e një platforme strategjike të qëndrueshme. Përqendrimi i kompetencave në një figurë politike: Kryeministri Albin Kurti ka uzurpuar rolin kryesor në politikën e jashtme, duke marginalizuar presidentin, Ministrinë e Jashtme dhe shërbimin diplomatik të karrierës.

Mungesa e koordinimit ndërinstitucional: Nuk ekziston një Këshill Kombëtar për Politikën e Jashtme; Kuvendi është i përjashtuar nga hartimi i strategjive ndërkombëtare; Raportimi dhe transparenca për politikën e jashtme mungojnë.

V. Pasojat afatgjata të diplomacisë pasive për Kosovën

- Izolim diplomatik progresiv - shtetet partnere humbin besimin në një shtet që nuk vepron. - Rritje e ndikimit serb dhe rus në Ballkan - boshllëkun e krijuar nga Kosova e mbushin aktorë me interesa kundër shtetësisë së saj. -

Dëmtim i legjitimitetit të brendshëm - mungesa e suksesit ndërkombëtar minon besimin qytetar në funksionalitetin e shtetit. - Bllokim në proceset integruuese - nga UNESCO e INTERPOL, te OKB dhe BE, pa diplomaci aktive nuk ka anëtarësim.

VI. Zgjidhje dhe rekomandime për rikthimin në diplomaci aktive

Ristrukturimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme: Profesionalistët të rikthehen në qendër të diplomacisë; Rrjeti diplomatik të funksionojë mbi baza të objektivave të shtetit.

Krijimi i Këshillit Kombëtar për Politikën e Jashtme: Bashkërendim ndërmjet Presidencës, Qeverisë, Kuvendit dhe institucioneve akademike. Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Politikën e Jashtme 2025 - 2030: Me objektiva të matshëm: njohje të reja, anëtarësime, partneritete.

Forcimi i diplomacisë publike dhe kulturore: Aktivizimi i diasporës si aset diplomatik; Diplomacia digjitale si platformë ndikimi në opinionin ndërkombëtar.

Përfshirja e ekspertëve të jashtëm dhe komunitetit akademik: Bashkëpunim me qendra ndërkombëtare kërkimore; Roli i universiteteve në politikën e jashtme duhet institucionalizuar.

VII. Heshtja diplomatike nuk është më një zgjedhje, por një rrezik kombëtar

Në kohën kur rajoni po ripërkufizohet nën ndikimin e forcave globale si Rusia dhe Kina, dhe kur BE dhe NATO po rishikojnë angazhimet e tyre në Ballkan, Kosova nuk mund të lejojë veten të mbetet spektatore. Diplomacia duhet të rikthehet si mjet esencial i shtetndërtimit dhe mbrojtjes së interesave strategjike.

Një shtet që hesht, humbet. Një shtet që vepron, ndërton.

Zbulohen mbetje mortore në Brekoc të Gjakovës, dyshohen se janë nga lufta e fundit



Gjakovë, 30 korrik - Në Brekoc të Gjakovës të mërkurën gjatë gërmimeve të kryera nga Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML) dhe Policinë e Kosovës, është konfirmuar gjetja e mbetjeve mortore që potencialisht i përkasin listës së personave të zhdukur.

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur në një postim në “Facebook” shkruan se pas kthimit në këtë lokacion

për gërmime të mëtejshme dhe vlerësuese, ekipet kanë hasur në eshtra. “Sot, në Brekoc të Gjakovës, gjatë gërmimeve të kryera nga Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML) dhe Policinë e Kosovës, është konfirmuar gjetja e mbetjeve mortore që potencialisht i përkasin listës së personave të zhdukur. Pas kthimit në këtë lokacion për gërmime të mëtejshme dhe vlerësuese,

ekipet tona kanë hasur në eshtra. Pas ekzaminimit antropologjik dhe identifikimit përmes ADN-së, ne do ta informojmë familjet dhe opinionin për identifikimin. Komisioni dhe partnerët institucional janë të përkushtuar për trajtimin me prioritet dhe kujdes të posaçëm të kësaj çështjeje, në shërbim të familjeve të viktimave dhe për të vënë drejtësinë në vend”, ka njoftuar Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur.

809 qytetarë të punësuar në komunat në veri përmes masës Qeveria për Familjet

PRISHTINË, 30 KORRIK - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar qytetarët se në kuadër të masës për mbështetjen e punësimit në komunat Leposaviq, Zubin

Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut deri më tani janë punësuar 809 qytetarë. “Falë interesimit nga ana e bizneseve, aktualisht janë të hapura mbi 1 000 vende të lira pune, të cilat

presin të plotësohen me punëkërkuar të regjistruar në Zyrat e Punësimit. Kujtojmë se kjo masë mbështet punësimin përmes subvencionimit deri në 70 % të pagës bruto për 6 muaj

me radhë. Ftojme të gjithë qytetarët që jetojnë në këto komuna që të regjistrohen pranë Zyrrave të Punësimit dhe të përfitojnë nga kjo mundësi”, ka njoftuar Ministria e Financave.



AVOKATI ARTAN QERKINI LIGJËRON PËR AVOKATËT E UKRAINËS

PRISHTINË, 30 KORRIK - Me kërkesë të Misionit të OSBE-së në Varshavë dhe të Ministrisë së Drejtësisë të Ukrainës, avokati Artan Qerkini më 31 korrik mban një ligjëratë për avokatët nga Ukraina me temën “Gjykimi i rasteve për krime lufte në mungesë”. Lajmin e ka bërë me dije Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

KMDLNj ka njoftuar se institucionet e Ukrainës gjatë tërë kohës së luftës kanë krijuar grupe të veçanta faktmbledhëse për krimet e luftës nga Rusia, për të krijuar një kontekst juridik për gjykime për krime lufte. “Grupet faktmbledhëse përbëhen nga hetues, prokurorë, avokatë për të drejtat e njeriut dhe aktivistë për të drejtat e njeriut. Për shkak se Ukraina gjendet në gjendje lufte dhe se të dyshuarit nuk janë të qasshëm për organet e drejtësisë, Ukraina ka vendosur që gjykimet të mbahen në mungesë në rast kur plotësohen kushtet ligjore dhe kur nuk janë në kundërshtim me parimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Avokati Artan Qerkini është

avokat i njohur kosovar, me të drejtë përfaqësimi dhe mbrojtje të të akuzuarve para Gjykatës Speciale në Hagë. Është avokat i vetëm që e ka fituar një rast para Gjykatës Kushtetuese të Gjykatës Speciale në Hagë. Si njohës i mirë i Ligjit për të Drejtën Humanitare dhe zakoneve të luftës, si dhe i të drejtave të njeriut, avokati Artan Qerkini është ftuar në shumë tryeza, debate dhe konferenca, vendore dhe ndërkombëtare ku trajtohen gjykimi i rasteve për krime lufte”, ka njoftuar KMDLNj.

Sipas KMDLNj-së, angazhimi i avokatit Artan Qerkini nga OSBE dhe Ministria e Drejtësisë për t’u ligjëruar avokatëve të Ukrainës për rastet e krimeve të luftës është një vlerësim i jashtëzakonshëm për një grup të avokatëve kosovarë që kanë krijuar një integritet të lartë profesional, si kusht i domosdoshëm për të qenë pjesë e barabartë e mbrojtjes të rasteve edhe më të rënda të krimeve të luftës, në përputhje me standardet ndërkombëtare. “Gjykimi i rasteve për krime lufte në përgjithësi dhe i atyre në mungesë në veçanti ishte një



sfidë e re për institucionet e drejtësisë në Kosovë si edhe të avokatëve mbrojtës shkaku i mungesës së përvojës në këtë fushë. Avokati Artan Qerkini është bashkëpunëtor i KMDLNj-së dhe ligjërues në këtë fushë, në të cilën ka treguar

dhe dëshmuar kapacitetin profesional që kërkohet për këto raste. KMDLNj shpreson se përvoja dhe përgatitja profesionale e avokatit Artan Qerkini do të jetë ndihmë e madhe për avokatët e Ukrainës që janë duke i bërë hapat e parë

në gjykimin e krimeve të luftës në mungesë në Ukrainë. Është edhe një rast i mirë dhe mundësi të nxitet dhe forcohet bashkëpunimi midis Odës së Avokatëve të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Ukrainës”, ka theksuar KMDLNj.

OSMANI PRITI NË TAKIM TENORIN RAMË LAHAJ DHE YJET NDËRKOMBËTARË TË FESTIVALIT NDËRKOMBËTAR TË OPERËS

Prishtinë, 30 korrik - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, priti në takim tenorin e mirënjohur ndërkombëtar, Ramë Lahaj, së bashku me të ftuarit specialë të Festivalit Ndërkombëtar të Operës “Ramë Lahaj”, në kuadër të edicionit të pestë të këtij festivali prestigjioz që tashmë është bërë pjesë e

rëndësishme e kalendarit kulturor evropian. Në përbërje të delegacionit ishin edhe: Ramón Vargas, një nga tenorët më të mëdhenj të operës botërore, Anita Rachvelishvili, mezzosopranoja gjeorgjiane me famë ndërkombëtare si dhe koordinatoren artistik të festivalit Besmir Vokopola.

Presidentja Osmani vlerësoi lart angazhimin e Ramë Lahajt në promovimin e artit dhe të kulturës së Kosovës në skenat botërore si dhe përkushtimin e tij për t’i sjellë artistët më të mëdhenj të operës ndërkombëtare në Prishtinë, duke ngritur nivelin e skenës kulturore në vendin tonë.



Gazetari Marin Mema nderohet me titullin “Qytetar Nderi i Deçanit”

Deçan, 30 korrik - Komuna e Deçanit ka nderuar gazetarin dhe hulumtuesin e shquar shqiptar, Marin Mema, me titullin “Qytetar Nderi i Deçanit”. Ky vlerësim i është dhënë Memës për kontributin e jashtëzakonshëm në dokumentimin dhe promovimin e historisë, kulturës dhe trashëgimisë shqiptare, si dhe për rolin e tij të

pazëvendësueshëm në informimin e opinionit publik mbi çështje me rëndësi kombëtare. Ceremonia e dorëzimit të titullit u zhvillua në ambientet e komunës së Deçanit në prani të ish-kryeministrit Ramush Haradinaj, kryetarit të komunës Bashkim Ramosaj, kryesuesit të Kuvendit Komunal, Hajdar Sutaj, ambasadorit të Republikës së

Shqipërisë, Petrit Malaj, rektorit të Universitetit “Haxhi Zeka”, përfaqësuesve të institucioneve lokale dhe qytetarëve të shumtë, të cilët shprehën mirënjohje për punën dhe angazhimin e pandalshëm të gazetarit Mema. Komuna e Deçanit falënderon Marin Mema për kontributin e çmuar dhe i uron suksese të mëtejshme në punën profesionale.



BIZNESET PA KONTRATA RREZIKOJNË SHKYÇJEN NGA RRYMA MË 31 KORRIK

Disa i kanë nënshkruar kontratat për furnizim me energji elektrike, disa ende refuzojnë. Ka raste edhe kur një kompani është ndarë në dy entitete të reja për ta shmangur daljen në tregun e hapur

PRISHTINË, 30 KORRIK - Më 31 korrik të gjitha bizneset në Kosovë me mbi 50 punëtorë, ose qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro, që nuk kanë lidhur kontratë me ndonjë furnizues të licencuar të energjisë elektrike, do të mbesin pa rrymë. Paralajmërimi ka ardhur nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) e cila thekson se afati 60-ditor i furnizimit të përkohshëm do të përfundojë më 30 korrik. Aktualisht kompanitë e mëdha private po furnizohen nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), e cila po vepron si Furnizues i Mundësisë së Fundit (FMF).

Ky furnizim është i përkohshëm, pasi nuk mund të zgjasë më shumë se 60 ditë dhe ofrohet me çmime më të larta sesa ato të tregut mesatar.

Pas skadimit të këtij afati ky furnizues nuk ka më të drejtë ligjore të ofrojë energji për këto kompani. “Kjo kërkesë rrjedh nga ligji dhe Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) e ka të pamundur të zgjasë apo ndryshojë këtë afat. Rrjedhimisht, më 31 korrik, të gjithë konsumatorët që nuk kanë furnizues do të shkyçen nga rrjeti energjetik”, thanë për Radion Evropa e Lirë nga ZRRE-ja.

Periudha 60-ditore e mbështetjes nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit ka nisur më 1 qershor, kur ka hyrë në fuqi vendimi i ZRRE-së për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike. Sipas këtij vendimi, të gjitha kompanitë private dhe publike që kanë mbi 50 punëtorë ose qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro janë të detyruara të kalojnë në tregun e hapur të energjisë, duke zgjedhur vetë një furnizues të licencuar. Kjo do të thotë se ato do të kalojnë në furnizim me çmime të cilat përcaktohen nga kërkesa dhe oferta në treg.

Deri më tani më shumë se 1 300 kompani me mbi 9 367 njësi matëse elektrike janë përfshirë në tregun e hapur.

Një kompani mund të ketë më shumë se një njësi matëse elektrike.

Nuk dihet numri i saktë i kompanive që kanë lidhur kontrata me furnizues të licencuar komercialë, por në ZRRE thonë se janë 2 198 njësi



matëse të tilla, kurse 7 169 pika matëse furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, që nënkupton se deri të enjten duhet ta zgjedhin furnizuesin e licencuar.

Çfarë duhet të bëjnë bizneset tani?

ZRRE-ja dhe KEK-u, si institucione përgjegjëse, u kanë bërë thirrje të gjitha bizneseve që sa më shpejt të kontaktojnë furnizues të licencuar dhe të nënshkruajnë kontratë të re për furnizim, për ta shmangur ndërprerjen e energjisë. Në Kosovë janë të licencuara 22 kompani për furnizim me energji elektrike, ndërsa tri të tjera janë në proces të licencimit. Një prej tyre është Operatori për Furnizim me Energji (KESCO), që furnizon shumicën e konsumatorëve familjarë dhe industrialë. Po ashtu, është edhe Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Me KESCO-n deri më tash kontratë kanë nënshkruar rreth 100 biznese dhe janë në proces

nënshkrimi dhjetë kërkesa të tjera. “Interesimi vazhdon të jetë shumë i lartë, sidomos në ditët e fundit - marrë parasysh që KESCO është kompania me përvojën më të gjatë në furnizim dhe tregtim të energjisë në Kosovë”, thuhet në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë nga kjo kompani. Ata shtojnë se janë duke punuar me kapacitete të shtuara në mënyrë që të përmbushin çdo kërkesë përpara datës 30 korrik, kur edhe përfundon furnizimi i përkohshëm nga KEK-u si Furnizues i Mundësisë së Fundit. Një prej kompanive që është në pritje për të nënshkruar kontratë para datës 30 korrik është kompania “Pestova” nga Vushtrria. Bedri Kosumi, pronar i kësaj kompanie, që numëron 260 punëtorë, thotë se është i detyruar të lidhë kontratë me KESCO-n. Ai tha se kompanitë e tjera të licencuara nuk i kanë paraqitur ndonjë ofertë. “Nuk kam mundësi tjetër, në mënyrë të ‘dhunshme’ po më obligojnë të lidh kontratë. Sepse, nëse ndërpritet energjia, rrezikohet prodhimi. Nuk kam ende

informata për detajet e çmimit të energjisë, por kryesorja është të mos mbesim pa rrymë dhe tani shikojmë”, tha ai.

Kurse një kompani prodhuese, e cila deri para pak muajsh kishte rreth 90 punëtorë, për t’i ikur liberalizimit të tregut, ka gjetur një alternativë tjetër. Pronari i kësaj kompanie (emër i njohur për redaksinë) tha se kompania është ndarë në dy entitete të reja: njëra e ka ruajtur emrin e vjetër, ndërsa tjetra është regjistruar me emër të ri.

Tani secila prej tyre ka më pak se 50 punëtorë.

REL-i e ka pyetur Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) dhe dhjetëra kompani të tjera të licencuara nëse kanë filluar të lidhin kontrata me biznese private apo publike, por vetëm njëra prej tyre është përgjigjur. Pronari i kompanisë “Enerco LLC”, Rinor Klaiqi, tha se ditët e fundit ka filluar të nënshkruajë kontrata me biznese, por nuk tregoi numrin e tyre dhe as çmimin e energjisë. Ai tha vetëm se energjinë për furnizim e siguron përmes Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX).

“Është një situatë pak stresuese për bizneset, sepse të gjithë e kanë lënë negociimin dhe nënshkrimin e kontratave për ditët e fundit, pasi kanë pritur që do të ndryshojë diçka”, tha Klaiqi.

Liberalizimi dhe pasojat për biznese

Përfaqësuesit e bizneseve vazhdimisht e kanë kundërshtuar këtë proces pasi, sipas tyre, çmimi i energjisë në tregun e hapur është shumë më i lartë.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka ripërsëritur kërkesën që procesi i liberalizimit të tregut të energjisë të pezullohet deri më 1 shkurt 2026. Kjo fazë, sipas tij, nevojitet për të pasur kompani konkurruese për tregtim të energjisë, njëherësh edhe që bizneset të mund të investojnë në energji alternative. Ai tha se shumica e bizneseve nuk kanë marrë ende oferta të favorshme dhe po detyrohen të lidhin kontrata të papërshtatshme. “Nuk është e mjaftueshme që bizneset të nxirren me dhunë në treg të lirë dhe të lihen në mëshirën e fatit ose në mëshirën e një ofertuesi, siç e kemi KESCO-n. Edhe pse ka kompani të tjera të licencuara, ende nuk kanë arritur që të krijojnë një ofertë konkrete”, tha Rafuna.

Nëse nuk ndodh pezullimi apo shtyrja, Rafuna thotë se prodhuesit do të dëmtohen rëndë duke zvogëluar vlerën e eksportit. Por, ZRRE-ja thotë se nuk ekziston asnjë bazë ligjore për zgjatjen automatike apo të përgjithshme të periudhës së furnizimit nga FMF përtej afatit të përcaktuar prej 60 ditësh.

Në Kosovë liberalizimi i tregut të energjisë është paraparë me Ligjin për Energjinë Elektrike të miratuar në vitin 2016, por zbatimi i tij është shtyrë për shkak të rrethanave të ndryshme. Kurse në vendet e Bashkimit Evropian procesi i liberalizimit të tregut të energjisë ka filluar në fund të viteve ’90 me qëllim rritjen e konkurrencës, efikasitetit, sigurisë dhe zgjedhjes për konsumatorët.

Në Ballkanin Perëndimor ky proces është ende në zhvillim e sipër.

Parandalohet një rast i shmangies nga taksat doganore

Prishtinë, 30 korrik - Policia e Kosovës, respektivisht njësitë patrulluese kufitare nga DRPK-Lindje (Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit Kaçanik) në Han të Elezit, kanë ndaluar një automjet të dyshuar me targa të Republikës së Maqedonisë së Veriut të drejtuar

nga një shtetas i Maqedonisë së Veriut, i cili, përkundër pohimit se nuk ka asgjë për të deklaruar te zyrtarët doganorë, pas ndaljes në pikën e kontrollit, gjatë kontrollit të detajuar në bagazh ka gjetur një sasi prej gjithsej 3 780 copë çorapesh të markave të mbrojtura tregtare si

Nike dhe Adidas, si dhe në pjesën e përparme të automjetit (në sirtarin e pasagjerit) 47 thika gjahu me këllëfë për të cilat nuk është paraqitur asnjë dokumentacion shoqërues.

Lidhur me rastin është njoftuar prokurori kujdestar nga Prokuroria Themelore në

Ferizaj, i cili ka urdhëruar që rasti të trajtohet si “Shmangie nga taksat doganore” dhe mallrat e dyshuara të konfiskohen përkohësisht dhe t’i dorëzohen Doganës së Kosovës. Automjeti është liruar, gjithashtu edhe personi i dyshuar është liruar në procedurë të rregullt.



‘IZRAELI PO E VDES URIE GAZËN’, NJË ZË NGA BRENDIA IZRAELIT AKUZON ATDHEUN E VET PËR GJENOCID



Shai Parnes, drejtuesi i fushatave të ndërgjegjësimit të B'Tselem ka dhënë një intervistë për La Repubblica. B'Tselem, bashkë me Physicians for Human Rights po e akuzon Izraelin për gjenocid.

–Në çfarë provash e bazon këtë akuzë?

“Në ditët e para të sulmit në Gaza, shumë zyrtarë të lartë izraelitë bënë deklarata gjenocidale. Kryeministri iu referua Gazës si ‘Amalek’, një term biblik që do të thotë armik absolut. Bibla na komandon neve që të shfarosim Amalek, përfshirë gra, fëmijë deri edhe kafshët e tyre shtëpiake. Presidenti izraelit tha, duke iu referuar palestinezëve përgjegjës për sulmin e 7 tetorit: ‘Ky është një komb i tërë’. Ministri i Mbrojtjes së Izraelit deklaroi se do të vendoste një bllokadë të

plotë në Gaza, pa energji elektrike dhe ushqim. Pas 22 muajsh, deklaratat janë bërë realitet. Kur flasim për gjenocid, flasim për qëllimin e shkatërrimit të aftësisë së palestinezëve që të vazhdojnë të jetojnë si një grup, zhdukjen e qyteteve të tëra si Rafah, e sistemeve me rëndësi jetike si kujdesi shëndetësor dhe infrastruktura. Izraeli po e vdes urie Gazën, përfshirë fëmijët, nuk ka rëndësi se kush je, mjafton t'i përkasësh atij grupi. Ky është përcaktimi i gjenocidit.”

–Ata që kundërshtojnë akuzat thonë se 60 mijë vdekje nuk quhen si gjenocid.

“Gjenocidi nuk është numri i të vrarëve, 60 mijë dhe kjo është shifër e vogël, por shkatërrimi i gjithë strukturave sociale që mundësojnë jetën në Gaza. Izraeli po shkatërron të ardhmen

duke zhdukur nga faqja e dheut sistemin arsimor, universitetet, shkollat.”

–Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë nuk ka dhënë ende një vendim.

“Sistemi i drejtësisë funksionon ngadalë, ne s'mund të presim me vite për një vendim. Duhet ta ndalojmë tani të gjithë këtë.”

–Qeveria izraelite kundërshton qëllimin që ti e akuzon, duke dhënë si provë shpërndarjen e ndihmave në Gaza.

“Ata nuk po shpërndajnë ndihma, janë të bllokuara që prej marsit. Ata nuk lejojnë evakuimin dhe mjekimin e të plagosurve. Kanë bombarduar xhami, universitete, pse? Është ideja që nuk ka palestinezë të pafajshëm. Dhe e thonë me zë të lartë.”

–A është kjo ide e përhapur edhe në shoqërinë civile izraelite?

“Sipas sondazheve, pjesa më e madhe e izraelitëve janë indiferentë, në mos mbështetës. Një shoqëri gjenocide nuk e di se ç'po bën gjatë procesit. Media në Izrael nuk flet për Gazën. Po, sulmi i tmerrshëm, mizor dhe kriminal i Hamasit më 7 tetor shkaktoi frikë te shumë izraelitë, kjo është e vërtetë. Por ka faktorë të tjerë që shpjegojnë si arritëm në këtë pikë. Struktura jonë e vërtetë politike është aparteidi, ndarja, supremacia hebreje dhe pandëshkueshmëri e plotë për këdo që lëndon palestinezët. Qeveria e tanishme është më e djathta, radikalja, mesianike dhe e dhunshme që ka pasur ndonjëherë Izraeli.”

–Megjithatë ka shumë izraelitë që protestojnë, marshojnë, flasin me zë të lartë, a po

ndryshon diçka?

“I admiroj shumë ata që flasin, që shkojnë për të mbrojtur palestinezët, por janë pakicë. Vetëm komuniteti ndërkombëtar mund ta ndalë qeverinë izraelite dhe deri më tani, ka dështuar. Bëjini thirrje liderëve tuaj që të veprojnë.”

–Çfarë ndien kur akuzon atdheun tënd për gjenocid?

“Ka një shprehje: Atdheu yt është vendi nga i cili të vjen turp. Nuk jam krenar për reputacionin e vendit tim. Por shoqëritë mund të ndryshojnë, e kanë bërë përgjatë historisë. Ka njerëz këtu, palestinezë dhe hebrenj, që edhe në kohëra të tmerrshme, punojnë që çdo qenie njerëzore, nga lumi në det, të ketë të njëjtat të drejta për lirinë dhe një jetë me dinjitet. Jam krenar për ta.”



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

UEFA delegon Genc Nuzën dhe Mervan Bejtullahun në Ligën e Konferencës

UEFA delegon Genc Nuzën dhe Mervan Bejtullahun gjyqtarë kryesorë në ndeshjet e raundit të dytë në Ligë e Konferencës. Nuzë i është besuar detyra për

ta ndarë drejtësinë në ndeshjen Zilina - Rakow e cila do të zhvillohet në stadiumin "MSK Zilina" në Zhilinë të Sllovakisë dhe do të asistohet nga Fatlum

Berisha dhe Bujar Selimaj, ndërsa gjyqtar i katërt do të jetë Dardan Çaka. Kjo ndeshje do të zhvillohet të enjten, më 31 korrik, nga ora 20:30, ndërkaq

Bejtullahu do ta gjykojë ndeshjen Gyori ETO - Pyunik, e cila do të zhvillohet në stadiumin "ETO Park" në Gyor të Hungarisë. Ai do të asistohet nga Edmond Zeqiri

dhe Fatmir Sekiraqa, ndërsa gjyqtar i katërt do të jetë Rrezart Hasanaj. Edhe kjo ndeshje do të zhvillohet të enjten, më 31 korrik, me fillim në orën 19:00

XHAKA PAS PARAQITJES TE SUNDERLANDI: DO TA SHKRUAJME HISTORINË

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 KORRIK - Futbollisti shqiptar që përfaqëson Zvicrën, Granit Xhaka, edhe zyrtarisht është futbollist i skuadrës së Sunderlandit. Kjo skuadër në edicionin e ri të futbollit do të jetë pjesë e Premierë Ligës, ndërsa Xhaka vlerësohet si ndër përforcimet kryesore. Futbollisti shqiptar në klubin anglez është paraqitur të mërkurën, kurse i ka kushtuar 20 milionë euro. 32-vjeçari që do ta bartë fanellën me numër 34 me Sunderlandin ka firmosur kontratë trevjeçare dhe do të ketë pagë vjetore prej 2.5 milionë eurosh. Siç dihet, Xhaka e njeh mirë kampionatin e Anglisë pasi prej vitit 2016 deri në vitin 2023 ka luajtur për Arsenalin, duke regjistruar 225 paraqitje, ku ka shënuar 17 gola e ka bërë 24 asistime, ndërsa ka fituar edhe në dy raste trofeun e FA Cup. Nga klubi i ri e kanë vlerësuar shqiptarin si një lojtar i kalibrit të lartë. "Ardhja e Granitit te Sunderlandi është një mbështetje e rëndësishme e ambicies sonë dhe dëshirës për të ndërtuar një ekip me të cilin tifozët tanë mund të jenë krenarë në Premierë Ligë. Arritjet dhe cilësia e tij nuk kanë nevojë për prezantim, pasi Graniti është një lojtar i kalibrit më të lartë brenda dhe jashtë fushës", ka thënë Kristjaan Speakman, drejtor sportiv i Sunderlandit. Pas realizimit të këtij transferimi ka folur edhe Xhaka, i cili ka premtuar se me përvojën që ka do të kontribuojë të shkruajë



historinë e klubit. "Kam një ndjenjë të mirë. Po e shoh se ku mund ta bëjmë një ndryshim të madh dhe dua të jem pjesë e kësaj. Ta shkruajmë historinë tonë. E njoh ligën dhe ajo që Sunderlandi pret nga unë është përvoja e madhe nga kampionate të ndryshme evropiane. Ende nuk kam mbaruar. Jam i uritur për të arritur shumë gjëra. Gjithashtu, kam një mentalitet të fortë për të punuar çdo ditë për t'i arritur synimet që i kemi në klub", ka thënë Xhaka, i cili e ka vlerësuar këtë si sfidën më të madhe në karrierën e tij futbolistike. "Kjo mund të jetë sfida më e madhe e karrierës sime deri më tani, por e pranova dhe këtë dua ta tregoj jo vetëm ditë pas dite, por edhe në fushë. Jam i sigurt se ky ekip do të japë gjithçka nga vetja në fushë dhe pavarësisht se çka ndodh, na duhet mbështetja e tifozëve. Ne do të japim gjithçka dhe shpresojmë t'i arrijmë synimet tona", ka shtuar Xhaka.

Leverkuseni falënderon Xhakën: Lojtar kyç në sukseset tona

Granit Xhaka vendosi të kalojë te Sunderlandi pas një periudhe të suksesshme te Bayer Leverkuseni. "Granit Xhaka ishte lojtar kyç në ekipin e Leverkusenit që fitoi kampionatin dhe Kupën e Gjermanisë në vitin 2024. Pranimi i kërkesës së tij urgjente për transferim është i përshtatshëm për Bayer 04 sipas kushteve dhe rrethanave të negociuara dhe është zgjidhja më e mirë për të gjithë të përfshirët. I urojmë Granitit të gjitha të mirat për pjesën tjetër të karrierës së tij", ka thënë Simon Rolfes, drejtor sportiv i Leverkusenit. Në sezonin e fundit tek ekipi gjerman, Xhaka në kampionat shënoi 2 gola, ndërsa dhuroi 7 asistime.

SHKURT

Jashari: Nuk luaj më në Club Brugge

Mesfushori shqiptar Ardon Jashari e ka shtuar presion mbi klubin belg, Club Brugge, për ta finalizuar transferimin te Milani. Sipas raportimeve të gazetës "Nieuwsblad", ai i ka bërë të qarta planet e ardhshme drejt drejtuesve të "rossonerëve". "Unë nuk do të luaj më këtu", raportohet se u ka thënë Jashari zyrtarëve të Club Brugge. 23-vjeçari ka kaluar një periudhë të paqëndrueshme gjatë përgatitjeve parasezonale, duke u stërvitur kryesisht i vetëm dhe duke munguar në ndeshjet miqësore. Jashari ka refuzuar oferta nga Premierë Liga dhe është i vendosur të bashkohet me Milanin. Nga ana e tij, Milani ndihet se ka shkuar sa më larg në negociata, duke bërë një ofertë përfundimtare prej 38 milionë eurosh, përfshirë bonuse. Megjithatë, Club Brugge vazhdon të kërkojë rreth 40 milionë euro për mesfushorin.

Fatlum Gashi edhe një vit pjesë e FC Besa Peja

Mesfushori Fatlum Gashi do të jetë pjesë e FC Besa Peja edhe në sezonin e ri futbolistik. Klubi pejan është shprehur i lumtur se kapiteni do të vazhdojë t'i mbrojë ngjyrat "verdhezi". "Kapiteni Fatlum Gashi vazhdon edhe për sezonin 2025/26 me FC Besa Peja! Lider në fushë dhe jashtë saj, Gashi e vazhdon rrugëtimin me klubin tonë, duke dëshmuar sërish besnikëri dhe përkushtim ndaj fanellës verdhezi. Jemi krenarë që e kemi kapitenin tonë në krye të skuadrës edhe një vit tjetër", thuhet në njoftimin e Klubit nga Peja.

Rrahmani në formacionin e javës në Çeki

Sulmuesi i Kosovës, Albion Rrahmani, është shpërblyer për paraqitjen e tij të mirë në ndeshjen e fundit me Sparta Pragën në kampionat. Rrahmani është përfshirë në 11-shën më të mirë të xhiros së dytë të Superligës së Çekisë pasi ndihmoi Spartanin të triumfojë ndaj Mlada Boleslavit fundjavën e shkuar. Sparta triumfoi me rezultatin e ngushtë 3:2, ndërsa Rrahmani në këtë fitore kontribuo me gol, të cilin e shënoi në minutën e 22-të, duke e zhblllokuar rezultatin. Rrahmani ishte startues te Sparta dhe u zëvendësua në minutën e 53-të, ndërsa për ekipin nga Praga kjo ishte fitorja e parë në sezonin 2025/26 pas barazimit në xhiron e parë. Sulmuesi "dardan" ishte një prej dy lojtarëve të Sparta Pragës që u përfshinë në formacionin e javës së dytë të kampionatit çek.

Trajneret japoneze, pjesë e stërvitjes së xhudos në Pejë

Pejë, 30 korrik - Në kuadër të bashkëpunimeve të vazhdueshme ndërkombëtare në xhudo, këto ditë Peja është bërë qendër e takimit të xhudisteve dhe trajnereve elitarë. Trajneret e mirënjohura japoneze Misato Nakamura

dhe Nami Nabekura po zhvillojnë stërvitje intensive me ekipin e Kosovës në xhudo, nën koordinimin e kryemjeshtrit Driton Kuka, trajnerit Fatos Tabaku dhe kampiones Olimpikë, Nora Gjakova. "Ky bashkëpunim

është pjesë e përpjekjeve tona për të sjellë përvojat më të mira botërore në shtëpinë e xhudos kosovare. Përveç trajnereve nga Japonia, jemi të lumtur të mirëpresim edhe xhudiste nga Suedia dhe Shqipëria, të cilat kanë shprehur dëshirë të

stërviten në Pejë dhe të ndajnë tatamin me xhudistet tona. Xhudo është më shumë se sport, është disiplinë, një kulturë dhe një urë që na lidh me botën", thuhet në njoftimin e Federatës së Xhudos së Kosovës.



Raçi, krenar me kalimin te Hajduku

SPLIT, 30 KORRIK - Mbrojtësi Ron Raçi ka thënë se është shumë i lumtur për mundësinë e ofruar dhe se është plotësisht gati për ta dhënë maksimumin për Hajdukun e Splitit. Raçi, 22-vjeçar, javën e shkuar ka bërë

hapin e madh në karrierë, duke u transferuar te skuadra e madhe kroate. Ai te Hajduku është transferuar nga Prishtina për 300 mijë euro, kurse me ekipin kroat ka firmosur kontratë deri në verën e vitit 2029. “Kam ëndërruar të

luaj për Hajdukun dhe ëndrra më është realizuar. Me padurim po e pres mundësinë për të luajtur dhe për ta ndjerë energjinë e tifozëve. E di se cilat janë pritjet për mua dhe jam gati për të dhënë gjithçka nga vetja për këtë fanellë. Dua

ta ndihmoj Hajdukun në arritjen e objektivave”, ka thënë Raçi. Raçi ka edhe një paraqitje me Kombëtaren e Kosovës, ndërsa krahas Prishtinës ka luajtur edhe për Ramiz Sadikun, Trepçën '89 dhe Besën e Pejës.



Allegri: Napoli, favorit për titullin

MILANO, 30 KORRIK - Trajneri i Milanit, Massimiliano Allegri, foli në konferencën për shtyp në prag të ndeshjes miqësore ndaj Perth Glory, skuadër australiane, që shënon edhe përfundimin e turneut veror të kuqezinjve. Allegri theksoi rëndësinë e sfidës dhe përgatitjeve të ekipit: “Jemi në fazën përfundimtare të turneut dhe kemi punuar mirë. Duhet të luajmë seriozisht dhe ta respektojmë kundërshtarin, i cili do ta japë maksimumin. Kjo ndeshje është e rëndësishme për ne për ta përmirësuar gjendjen fizike dhe taktike, por edhe për aspektin mental. Kundër Arsenalit dhe Liverpoolit ishte më e lehtë të përqendroheshim, por nesër do të shohim sa kemi përparuar në këtë drejtim dhe sa e respektojmë kundërshtarin”. Pyetjes nëse do të aktivizohen lojtarë të rinj italianë, Allegri iu përgjigj: “Fjala ‘të rinj’ në merkato është shumë relative. Nëse një lojtar është i mirë, ai do të luajë. Ne kemi një skuadër mjaft të re, që është një avantazh për të ardhmen”. Sa iu përket favoritëve për titullin në Serinë A, Massimiliano Allegri ka theksuar se është Napoli, kurse më pas ka renditur Juventusin, Atalantën, Romën, Fiorentinën dhe Lazion. “Napoli është favorit për ta fituar



titullin, pasi zakonisht fituesi është gjithmonë favorit. Pastaj vjen Interi, që është shumë i fortë dhe punon shumë prej vitesh. Më pas janë Juventus, Atalanta, Roma, Fiorentina dhe Lazio, që të gjitha do të luftojnë për katër vendet e para”, ka deklaruar ai. Në lidhje me faktin nëse mungesa në kompeticionet evropiane është një avantazh, Allegri ka pohuar se ky është një disavantazh. “Ndoshta mund të stërvitemi gjatë gjithë javës, por një disavantazh është se Milani duhet të luajë në Ligën e

Kampionëve për t’u përballur me skuadra të mëdha dhe për të fituar përvojë në nivele të larta”. Në fund, trajneri foli edhe për prurjet e reja dhe zhvillimin e skuadrës: “Modriqi dhe Gimenezi do t’i bashkohen grupit së shpejti, ndërsa disa të rinj do të kthehen te skuadrat e moshave. Do të kemi 15 ditë përgatitje para debutimit në Kupën e Italisë ndaj Barit. Estupinan është një lojtar i fortë dhe po përshtatet me një grup lojtarësh me vlera të rëndësishme brenda dhe jashtë fushës”.

Rosbergu sulmon Norrisin: Hamiltoni nuk do t’i kishte bërë ato gabime

Woking, 30 korrik - Kanë mbetur 11 gara deri në fund të Botërorit 2025 të Formulës 1, por gjithçka tregon se kampioni do të jetë një nga dy pilotët e McLarenit. Ekziston një statistikë që tregon dominimin e makinave me ngjyrë portokalli. Në pistën prestigjioze “Spa-Francorchamps”, ata siguruan dopietën e tretë radhazi. Për më tepër, ekipi me bazë në Woking ka fituar pesë nga gjashtë garat e fundit të kampionatit dhe një total prej 10 nga 13 të mbajtura deri më tani. Kështu që ky Kampionat Botëror do të jetë i pari për Oskar Piastrin ose Lando Norrisin. Në Çmimin e Madh të Belgjikës, australiani përsëri e



tejkaloj shokun e tij të skuadrës, edhe pse Norrisi nisi nga pozicioni i parë. “Nuk pata kthesën 1 më të mirë, por Oskar do të më kishte kaluar gjithsesi. Ai kishte ritëm dhe rrjedhë më të mirë. Nuk jam shumë i zhgënjyer, por duhet të rishikoj se çfarë mund të kisha bërë më mirë”, ka thënë piloti britanik pas garës së gjatë në Spa, event që e çoi në -16

pikë nga shoku i skuadrës. Lando bëri edhe gabime në pika të tjera që i kushtuan kohë të çmuar. Ai që i hedh benzinë zjarrit në luftën e brendshme të McLarenit është “i pamëshirshmi” Nico Rosberg. “Nëse po shkon me kulmin e shpejtësisë, mund të bësh gabime. Pyes veten nëse dikush si Lewis Hamiltoni do të kishte bërë ato gabime që bëri Norris. E kemi parë Hamiltonin të shtyjë si i çmendur në një garë shumë herë. Kur erdhi puna te koha e goditjes, nuk e pamë t’i bënte ato gabime. Nuk mendoj se kjo do t’i kishte ndodhur atij. Lewisi nuk do t’i kishte bërë ato tri gabime”, ka shtuar kampioni Botëror i F1 në vitin 2016.

SHKURT

Manaj vazhdon karrierën te Sharjah FC

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Rey Manaj, ka vendosur që karrierën ta vazhdojë në Lindjen e Mesme. Manaj është larguar nga Sivasspori i Turqisë për t’u transferuar te Sharjah FC në Emiratet e Bashkuara Arabe, ku edhe është paraqitur. Me ekipin e ri, Manaj ka firmosur kontratë dyvjeçare me pagë vjetore prej 2.5 milionë eurosh, kurse Sharjah FC i ka paguar skuadrës së Sivassporit 2 milionë euro për kartonin e tij. 28-vjeçari largohet nga Sivasspori pas dy sezoneve, përgjatë të cilave ka shënuar 30 gola në 60 ndeshje kampionale. Te Sharjah FC, Manaj do të jetë bashkëlojtar me mesfushorin shqiptar, Feta Fetai që ka 6 ndeshje të luajtura për Kombëtaren U21 të Shqipërisë.

Chelsea kërkon 25 milionë paund për Brojën

Skuadra e Chelseat ka vendosur një çmim prej 25 milionë paundësh për kartonin e Armando Brojës, sipas raportimeve nga “The Athletic”. Kjo shifër konsiderohet e lartë duke marrë parasysh historinë e dëmtimeve të sulmuesit shqiptar dhe mungesën e aktivizimit në sezonet e fundit. Broja nuk bën pjesë në planet e trajnerit dhe pritet të largohet këtë verë, por strategjia e klubit për të kërkuar një shumë kaq të madhe ka shkaktuar habi, sidomos në një kohë kur Chelsea ka nevojë të shesë lojtarë jashtë projektit. Nëse pretendimet nuk ulen, ka rrezik që Broja të mbetet sërish në stol.

PSG-ja ofron 80 milionë euro për Gavin

Paris Saint-Germain është gati të ofrojë 80 milionë euro për mesfushorin e Barcelonës, Gavi, sipas “Fichajes”. Trajneri Luis Enrique, që e njeht mirë lojtarin nga Kombëtarja spanjolle, e dëshiron si pjesë kyçe të projektit të tij në Francë. Barcelona, përballë vështirësive financiare dhe kufizimeve nga rregulli 1:1, mund të detyrohet të marrë vendime të vështira këtë verë - përfshirë shitjen e lojtarëve të rëndësishëm. Gavi shihet nga PSG-ja si zëvendësues ideal për Fabian Ruiz dhe përforcim i përshtatshëm në mesfushë me Vitinha dhe Joao Neves.

Flick: Araujo nuk do të largohet

Ronald Araujo nuk do të largohet nga Barcelona gjatë kësaj merkatoje verore. Konfirmimi vjen nga trajneri i ri i katalanasve, Hansi Flick, i cili në një konferencë për shtyp ka hedhur poshtë zërat që lidhnin mbrojtësin uruguaiian me një transferim të mundshëm. “Ka gjithmonë shumë zëra për Araujo, por nuk kam marrë asnjë sinjal apo lajm që ai dëshiron të largohet. Kam në dispozicion një skuadër të madhe dhe me shumë cilësi. Çdo pozicion është i mbuluar, madje në disa kemi edhe nga tre lojtarë. Nuk është e lehtë për t’u menaxhuar, natyrisht, por jam i kënaqur”, ka thënë Flick. Trajneri gjerman shtoi se është i befashuar nga spekulimet që qarkullojnë për mbrojtësin: “Më habit që dalin këto zëra për Ronaldin. Unë jam shumë i kënaqur me skuadrën që kam”. Deklaratat e Flickut u japin fund spekulimeve dhe konfirmojnë se Araujo do të vazhdojë të jetë një pjesë kyçe e projektit të ri të Barcelonës për sezonin e ardhshëm.

Luis Diaz kalon te Bayerni për 75 milionë euro

Luis Diaz është zyrtarisht lojtari më i ri i Bayern Munchenit. Klubi gjerman ka arritur një marrëveshje të plotë me Liverpoolin për transferimin e sulmuesit kolumbian kundrejt 75 milionë eurove, duke mbyllur

një nga sagat më të përfolura të merkatos së verës. Diaz ka firmosur një kontratë deri më 30 qershor 2029 dhe do ta mbajë fanellën me numrin 14. Sipas medieve gjermane, paga e tij te Bayerni do të jetë 14 milionë

euro në vit, duke katërfishuar rolgën që merrte te Liverpooli, ku ishte ndër lojtarët më pak të paguar të skuadrës. Dëshira e “Lucho”-s për ta lënë “Anfieldin” kishte nisur të flitej që në fillim të korrikut dhe më në fund u bë

realitet. Diaz, i cili ishte një nga objektivat kryesore të trajnerit Vincent Kompany, pritet të jetë një shtesë e madhe për repartin ofensiv të kampionëve të Gjermanisë. Ky transferim është i treti më i shtrenjtë në historinë e

Bayernit, pas Harry Kane (95 milionë) dhe Lucas Hernandez (80 milionë). Gjithashtu, barazon James Rodriguezin si transferimi i dytë më i shtrenjtë për një futbollist kolumbian, pas Jhon Duran (77 milionë tek Al-Nassri).

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania kompanisë “Romer Wood House” shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Fabrikën e përpunimit , montimit dhe ekspozimit të objekteve nga druri i parafabrikuar, në Z.K. Sigë, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.09.2025 në ora 11:00 në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës, do të organizohet debat publik nga Kompania kompanisë “Romer Wood House” shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3422360809>

Passwordi: 617875

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë kompanisë “Romer Wood House” shpk, Pejë, për Pëlqim Mjedisor, – për Fabrikën e përpunimit, montimit dhe ekspozimit të objekteve nga druri i parafabrikuar, në Z.K. Sigë, Pejë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania kompanisë “Mishtore Egzoni” shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Fabrikën e përpunimit dhe konservimit të mishit “Mishtore Egzoni” në Bellpojë. Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.09.2025 në ora 10:00 në Objektivin e ShFMU “Dardania”, Rr. “Ardian Krasniqi” Pejë, do të organizohet debat publik nga Kompania kompanisë “Mishtore Egzoni” shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/2693380475?pwd=ZEpzTUNmaHITRVN3VXZqRU5kaXRTUT09>

Meeting ID: 269 338 0475

Passcode: BBqP2x

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë kompanisë “Mishtore Egzoni” shpk, Pejë, për Pëlqim Mjedisor, – për Fabrikën e përpunimit dhe konservimit të mishit “Mishtore Egzoni” në Bellpojë. Pejë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania kompanisë “Ego Elsa” shpk, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Grumbullimin, Ndarjen, Trajtimin e Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënojave, në Z.K. Koliq, Prishtinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.09.2025 në ora 09:00 në Objektivin e SHFMU “Ganimete Tërbeshi” Llukar, Prishtinë, do të organizohet debat publik nga Kompania kompanisë “Ego Elsa” shpk, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë kompanisë “Ego Elsa” shpk, Graçanicë, për Pëlqim Mjedisor, – për Grumbullimin, Ndarjen, Trajtimin e Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënojave, në Z.K. Koliq, Prishtinë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Taolant Bezhi shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- GSH Services SH.P.K. shpall t6ë pavlefshme numrin unik identifikues 812245927 të lëshuar nga ARBK.

- Florjana Ndrecaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe certifikatën diplomën e shmm “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- D.P.H “Namiku” Rahovec shpall të pavlefshme numrin unik identifikues 810393570 të lëshuar nga ARBK.

- Endrit Cena nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.M. “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Vetermikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

F2/BNJ



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM “Pastrimi” Sh.A. konkretisht Nenin 11 dhe 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A, në Vendimin e datës 28.07.2025 me numër të protokollit 02/01/557 të Krveshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK ME AFAT TË CAKTUAR

Titulli i vendit të Punës:	Punëtor i Bartjes
Nr. i kërkuar:	Tetëmbëdhjetë (18) pozita Njësia Operative Fushë Kosovë në KRM “Pastrimi” SH.A
Numri i Referencës:	NJOFK/KJ/21/2025
Koeficienti/Paga mujore:	Niveli XIII
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës:	Me kohë të caktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Bënë mbledhjen e mbeturinave në zonat e caktuara;
- Bënë zbrazjen e kontejnerëve në automjet/kamion;
- Bënë pastrimin e zonës përreth kontejnerëve;
- Bazuar në planin operativ dhe urdhëresës së punës bënë pastrimin dhe larjen e rrugëve dhe trotuareve;
- Bënë pastrimin e trotuareve dhe rrugëve nga bora dhe hudhjen e kripës;
- Bënë largimin e kafshëve të ngordhura nga rruga dhe vendosjen e tyre në kontejnerin përkatës;
- Është përgjegjës për mirësjellje ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të kompanisë;
- Është përgjegjës që pas mbledhjes së mbeturinave, kontejnerët të vendosë në vendin paraprak;
- Kujdeset dhe është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të mjeteve të punës dhe kontejnerëve;
- Kryen edhe punë të tjera me të cilat e angazhon udhëheqësi;
- Për punën e tij i raporton Kryepuntorit të Bartjes në Njësi Operative.

2. Afati i kontratës

KRM "Pastrimi" Sh. A dhe Komuna e Fushë Kosovës kanë Memorandum Bashkëpunimi dhe Marrëveshje për angazhimin e punëtorëve me kontrata me afat të caktuar.

Kontrata për këtë pozitë skadon më: 30 Qershor 2026.

3. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

4. Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ Arsimimi i kërkuar: Shkollim i mesëm apo shkollimi fillor

5. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Aftësi të arsyetimit logjik;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

6. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Applikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
CV - në	✓
Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	✓
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës	✓
Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale, JO më të vjetër se 3 muaj	✓

7. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:

7.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:

7.1.1 duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh. A.

7.1.2 në Zyrat e Burimeve Njerëzore në KRM “Pastrimi” SII.A.

7.2 Dorëzimi i aplikacionit:

7.2.1 bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës:
punesimi.krmpastrimi@gmail.com dhe

7.2.2 në rastet e konkurseve të brendshme, të pozitave teknike mund të bëhet edhe në formë fizike.

8. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik;

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 31/07/2025 deri me datën 14/08/2025.

Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

9. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së dhe me intervistim (testi me gojë).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në 25 pikë;
- ✓ Intervista (testi me goje) vlerësohet deri në 75 pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronik dhe individualisht.

11. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:


Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë:

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit.

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.



F2/BNJ



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" A.D

Na osnovu Zakona o radu br. 03 / L-212, posebno člana 8, u Uredbi br. 07/2024 o radnom odnosu u kompaniji RPO "Pastrimi" a.d. konkretno članovi 11 i 12, u Uredbi br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "Pastrimi" A.d., u Odluci od 28.07.2025. godine sa brojem protokola 02/01/557 izvršnog direktora RPO "Pastrimi" A.d, objavite ovo:

JAVNI KONKURS NA ODREĐENO VREME
Za popunjavanje posla

Naziv posla:	Kategorija C i C1 vozač
Ne. Obavezno:	Četiri (4) pozicije: Operativna jedinica Kosovo Pole u RPO "Pastrimi" A.D.
Referentni broj:	NJOFK/KJ/22/2025
Koeficijenti / Mesečne plate:	Nivo XI
Trajanje ugovora o radu:	Vremensko ograničenje

Dužnosti i odgovornosti:

- Vozi vozilo u skladu sa radnim nalogom u regionu koji mu je dodelio vođa;
- Odgovoran je za putovanje ulicama i određenim područjima za prikupljanje smeća u njihovim prostorijama koje se nalaze u skladu sa planiranjem kompanije;
- Proverite životnu sredinu kako biste identifikovali otpad koji treba uzeti i osigurali da se posao obavlja u skladu sa zdravstvenim i bezbednosnim pravilima koja ne ometaju saobraćaj;
- U saradnji sa liderom, planira najefikasnije rute za prikupljanje smeća iz područja koje mu je dodeljeno kako bi se smanjio gubitak vremena i sačuvali troškovi putovanja;
- Odgovoran je za obezbeđivanje da je vozilo bezbedno i spremno za upotrebu, uključujući kontrolu nivoa goriva, kontrolu pritiska u gumama i opštu negu vozila.
- Vozač mora da obezbedi da se otpad klasifikovan kao eksploziv stavlja i transportuje sa posebnom pažnjom, u skladu sa propisima o opasnom otpadu;
- Izveštava o svim vanrednim situacijama koje se dešavaju na dužnosti, uključujući hitne slučajeve, oštećenje vozila ili kršenja bezbednosti;
- Brine i poštuje pravila drumskog saobraćaja;
- Održava evidenciju odgovornosti, u skladu sa propisima i politikama kompanije.
- Obavlja i druge poslove na zahtev direktnog vođe;
- Za svoj rad odgovoran je rukovodiocu Operativne jedinice.

2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

- biti državljanin Republike Kosovo,
- da poseduju najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- Biti e/sposoban za obavljanje relevantne dužnosti;
- Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- Ne bi trebalo da postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljne prekršaje u javnoj ustanovi;
- Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- Da uspešno prode procedure prijema utvrđene u zakonu.

3. Opšti formalni zahtevi

- Potrebno obrazovanje: Srednje obrazovanje
- Potrebno radno iskustvo: 2 godine radnog iskustva

4. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- Vještine logičkog zaključivanja i analize;
- Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- Istraživanje, analitičke, evaluativne veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- Sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i diskrecionog prava o pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, što pomaže u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i kako ih dostaviti

Prijava popunjena i potpisana od strane kandidata	✓
CV - u	✓
Kopije diploma koje dodeljuju obrazovne ustanove	✓
Kopija dokaza o zaposlenju (penzioni fond, potvrda ili ugovor o radu)	✓
Kopija sertifikata o obuci i kursu (poželjno)	✓
Kopije procena posla za poslednje dve godine (poželjno)	✓
Kopija lične karte/pasoša/uverenja o državljanstvu Republike Kosovo	✓
Dokaz da nije osuđen za krivično delo, NE stariji od 3 meseca	✓

6. Kako se prijaviti na konkurs i prijaviti se:

- 6.1 Povlačenje službenih obrazaca se vrši:
- * preuzimanjem sa zvaničnog sajta na društvenoj mreži Facebook: Regionalna kompanija za otpad "Pastrimi" AD.
- * u Kancelarijama za ljudske resurse RPO "Pastrimi" a.d.

6.2 Podnošenje prijave:

- * se vrši samo elektronskim putem preko adrese: punesimi.krmpastrimi@gmail.com i
- * U slučajevima internih takmičenja, tehničke pozicije se mogu održavati i u fizičkom obliku.

7. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa;

Javni konkurs traje 15 dana od 31.07.2025. do 14.08.2025. godine.

Poslednji put za prijem prijava je 16:00 časova.

Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se razmatrati.

8. Metod procene i kriterijumi ocenjivanja.

Evaluacija kandidata vrši se na osnovu biografije, i putem intervjua (usmeno testiranje).

- ✓ CV kandidata se ocenjuje do (25) bodova;
- ✓ Intervju (usmeni test) se ocenjuje do (75) bodova.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno sto (100) bodova, pri čemu je prolaznost postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog konkursa.

9. Kako obaveštavati i komunicirati sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan kalendar postupka zapošljavanja:

Faza pre verifikacije aplikacija do 7 dana;

Faza pismenog testa do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervjua do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervjua.

Napomena: Nepotpuna, neskenirana dokumenta, kao i ona koja stižu nakon isteka roka konkursa neće biti razmatrana.



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë –

Kosovë, www.kolegjbiznesi.com, info@kolegjbiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **30.05.2025**, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë:

SHBALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

- Dy (2) mësimdhënës në programin – **Ekonomik**,
- Dy (2) mësimdhënës në programin – **Juridik**,
- Dy (2) mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave**,
- Një (1) mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike**,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025**.

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjbiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjbiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjbiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.



TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

